

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, gjyqtari Mehmet Ndrecaj, me procesmbajtësen Shyhrte Sopaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. G. nga fshati komuna e , sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren, PP.nr.36-4/16 të datës 12.05.2016, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me paragrafin 1 të KP-së, në shqyrtimin fillestare në prezencën e Prokurorit të Shtetit Beqë Shala, të dëmtuarit E. K. me përfaqësuesin e tij ligjor T. Kr. dhe të akuzuarit S. G., me datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### AKT GJYKIM

#### I akuzuari:

S. G., nga i ati M. , dhe e ëma L. , e linudr. i lindur me 20.04.1978. në fshatin komuna e , ku edhe tani banon, i martuar, baba i tre fëmijëve, bujk, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. të ID 100754287.

#### ËSHTË FAJTOR

Se më datën 30.12.2015 rreth orës 13:40 minuta në drejtimin Prizren - Gjakovë duke shkel ligjin mbi trafikun publik vepron në kundërshtim me nenin 49 dhe 54 të ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor dhe nga pakujdesia rrezikon trafikun publik aq sa venë në rrezik jetën e njerzve dhe pasurinë në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin transportues të markës "Audi" ngjyrë hiri me targa 07-521 BJ, kur arrin në vendin kritik, shpejtësinë e lëvizjes së automjetit nuk i'a përshtat kushteve dhe rrethanave në rrugë, nga pakujdesia humb kontrollin mbi automjet sepse i del goma e parë e automjetit të anës së majtë ku së pari e godet automjetin e udhëtarëve të markës "Audi" ngjyrë hiri me targa 07-521 BJ, të cilin e drejtonte Rest Zg. , i cili në momentin kritik ishte dule lëvizur nga drejtimi i kundërt, më pas goma kthehet parapa dhe godet këbësorin - të miturin B. K., e më pas godet edhe automjetin e udhëtarëve të markës "Audi" ngjyrë të zezë me targa 07-45-08 në 'pronësi të A. G. , i cili në momentin kritik ishte i parkura në parking me ç'rast pëveç dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pëson këmbësori B. K. , lëndime këto të konstatuara në mendimin e ekspertit mjekoligjor dr. F. Dj. të dhënë me dt. 01.05.2016.

Kështu që ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KP-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4, 6, 7, 17, 41, 42, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, të akuzuarit i'a shqipton:

#### DËNIMIN ME KUSHT

Duke ja vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.



Të dëmtuarit: B. K. Kylli, Arsi (Besnik) G. qe të dy nga fshati Komuna e Tropojës dhe Reçica (Shefijë) Zengj i nga fshati Komuna e Kamenicës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

I akuzuari, obligohet që ti paguaj shpenzimet e procedurës aq sa do të jenë ato sipas llogarisë së arkës së gjykatës, për ekspertizën mjeko-ligjore shumën prej 20 euro, për ekspertizën e komunikacionit shumën prej 40.88 euro, në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Ars vetim

Prokuroria Themelore në Prizren ka paraqitur aktakuzë PP.nr. 36-4/16 të datës 12.05.2016, kundër të akuzuarit Sh. T. G., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga numri 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KP-së.

Gjykata më datën 09.06.2017 ka mbajtur shqyrtimin fillestar në prezencën e prokurorit të dëmtuarit dhe të akuzuarit. Pas kësaj u lexua atakuza nga ana e Prokurorit të Shtetit, i shpalosи dhe bëri prezantimin e të gjitha provat materiale në të cilat mbështetët aktakuza. I akuzuari deklaroj se e ka kupuar aktakuzën dhe e pranojë fajësinë për veprën penale të kryer dhe pranueshmërinë e provave.

Gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se më datën 2015 rrreth orës 13:40 minuta në 04.01.2015 në drejtimin duke shkel ligjin mbi trafikun publik vepron në kundërshtim me nenin 49 dhe 54 të ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor dhe nga pakujdesia rrezikon trafikun publik aq sa venë në rrezik jetën e njerzve dhe pasurinë në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin transportues të markës "C 111" ngjyrë hiri me targa 04-111, kur arrin në vendin kritik, shpejtësinë e lëvizjes së automjetit nuk i'a përshtat kushteve dhe rrethanave në rrugë, nga pakujdesia humb kontrollin mbi automjet sepse i del goma e parë e automjetit të anës së majtë ku së pari godet automjetin e udhëtarëve të markës "C 111" ngjyrë hiri me targa 04-111, të cilin e drejtonte R. Z., i cili në momentin kritik ishte dule lëvizur nga drejtimi i kundërt, më pas goma kthehet parapa dhe godet këbësorin - të miturin B. K., e më pas godet edhe automjetin e udhëtarëve të markës "C 111" ngjyrë të zezë me targa 04-111, në 'pronësi të A. G., i cili në momentin kritik ishte i parkura në parking me ç'rast pëveç dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pëson këmbësori Blerim Kryezi, lëndime këto të konstatuara në mendimin e ekspertit mjekoligjor dr. F. D. të dhënë me dt.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat, gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit dhe çdo provë tjetër, dhe se aktakuza nuk përbante asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruara si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.



Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësin e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduesë të parapara si në nenin 73 të KPK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, se në gjykim ka patur qëndrim korrekt, pranimi i fajësisë, nuk ka qenë i dënuar më parë, është bujk, kryefamiljar dhe mbajtës i familjes. Kështu që duke mos gjetur rrethana posaçërishtë rënduesë gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KP-së dhe se ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë konform nenit 463 par. 2 të KP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 453 par. 4 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.998/16, me datë 09.06.2017**

**Procesmbajtësja**  
**Shyreste Sopaj**



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njejtë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.